

**VENDIM**  
**Nr.845, datë 16.11.2005**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.134, DATË 18.2.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NGRITJEN E SEKRETARIATIT TË KOMITETIT KOORDINUES TË MINISTERIALIT TË MBROJTJES SË EUROPËS JUGLINDORE (SEDM-CC) DHE TË KOMITETIT DREJTUES POLITIKO-USHTARAK TË FORCËS PAQERUAJTËSE SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS JUGLINDORE (PMSC/MPFSEE)NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të nenit 100 Kushtetutës, të nenit 4 të marrëveshjes dhe protokollit shtesë “Për krijimin e forcës shumëkombëshe të Europës Juglindore”, ratifikuar me ligjin nr.8544, datë 4.11.1999 dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.134, datë 18.2.2005 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2 të bëhen këto ndryshime:
    - Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë vijon:  
“Sekretariati i SEDM-CC-së dhe PMSC/MPFSEE-së të përbëhet nga 13 veta, civilë dhe ushtarakë, nga personeli i Ministrisë së Mbrojtjes:
      - a) kryetari të jetë zëvendësministri i Mbrojtjes;
      - b) këshilltari të jetë civil ose ushtarak;
      - c) shefi i sekretariatit të jetë ushtarak, në nivel drejtor drejtorie;
      - ç) shefi i sektorit PMSC-së të jetë ushtarak;
      - d) dy specialistë për marrëdhëniet ndërkombëtare në sektorin e PMSC-së, të jenë ushtarakë ose civilë, njëri prej të cilëve të jetë përkthyes i gjuhës angleze;
      - dh) shefi i sektorit të SEDM-CC-së të jetë ushtarak;
      - e) dy specialistë për projektet e SEDM-së në sektorin e SEDM-CC-së, të jenë ushtarakë ose civilë;
      - ë) shefi i sektorit të protokollit dhe administratës të jetë ushtarak;
      - f) specialist dhe koordinator i SEDM-së në sektorin e protokollit dhe administratës, të jetë ushtarak ose civil;
      - g) shefi i zyrës së planfinancës të jetë ushtarak ose civil;
      - gj) specialist, llogaritar ose arkëtar në zyrën e planfinancës të jetë ushtarak ose civil.”.
    - Në fund të kësaj pike shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:  
“Shtesat në personelin e sekretariatit të përfshihen brenda numrit limit të punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes.”.
  2. Paragrafi i parë i pikës 5 ndryshohet si më poshtë vijon:  
“Pagat e personelit të sekretariatit të jenë të njëjta me pozicionet e administratës publike, si më poshtë vijon:
    - a) këshilltari me atë të drejtorit të drejtorisë;
    - b) specialistët civilë të paguhen me pagën e specialistit të nivelit të lartë;
    - c) ushtarakët të paguhen sipas gradës dhe funksionit.Punonjësit civilë të sekretariatit e përfitojnë këtë pagë deri në datën e përfundimit të kryesimit nga Shqipëria të sekretariatit të SEDM-së.”.
  3. Në pikën 9 shtohet shprehja “...Ministria e Punëve të Jashtme...”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**